



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.607, datë 04.12.2020

PËR

**KUALIFIKIMIN E KANDIDATIT Z. {...}
PËR NË FORMIMIN FILLESTAR NË SHKOLLËN E MAGJISTRATURËS,
PËR MAGJISTRAT, PROFILI GJYQATAR, PËR VITIN AKADEMIK 2020-2021**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, në mbledhjen e datës 04.12.2020 pasi u njoh me materialet e çështjes dhe Relacionin “Për gjendjen e faktit dhe ligjin e zbatueshëm në lidhje me verifikimin e kushteve dhe kriterëve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar, për magjistrat (profili gjyqtar), në Shkollën e Magjistraturës, të kandidatit z. {...}”, përgatitur nga relatori z. Alban Toro, si dhe pasi shqyrtoi propozimin për kualifikimin kandidatit z. {...} për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, për vitin akademik 2020-2021,

VËREN

I. PROCEDURA E VERIFIKIMIT

1. Z. {...} është kandidatë për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, profili gjyqtar, në kushtet kur:

a) është vlerësuar nga Shkolla e Magjistraturës, në bazë të Raportit të Vlerësimit Përfundimtar të datës 19.06.2020, se plotëson kriteret e pranimit në formimin fillestar për magjistrat sipas nenit 28 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (më poshtë referuar si Ligji i Statusit);

b) ka marrë pjesë në provimin e organizuar nga Shkolla e Magjistraturës sipas nenit 31 të Ligjit të Statusit, u përfshirë në listën e renditjes së kandidatëve fitues në formimin fillestar për magjistrat, profili gjyqtar, të miratuar me Vendimin nr.22, datë 16.07.2020, të Këshillit Drejtues të Shkollës së Magjistraturës,

përcjell pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor me Shkresën nr.492 prot., datë 17.07.2020 (protokolluar me nr. 3383 prot., datë 17.07.2020).

2. Me Vendimin nr.257, datë 20.07.2020, mbështetur në nenin 32 të Ligjit të Statusit, si dhe në Vendimin e tij nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë” (më poshtë referuar si Vendimi 75/2019), Këshilli i Lartë Gjyqësor ka vendosur fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për në formimin fillestar për magjistratë, profili gjyqtar, në Shkollën e Magjistraturës, për vitin akademik 2020-2021, duke caktuar relatorin për çdo procedurë verifikimi për secilin kandidat, ku në bazë të shortit, për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...} si relator u caktua z. Alban Toro.

3. Më datë 20.07.2020, në respektim të detyrimeve të përcaktuara në Seksionin A, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, u njoftua : - për fillimin e procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit; - për caktimin e relatorit të kësaj procedure verifikimi; - për të drejtën që kishte për të kërkuar përjashtimin e relatorit të caktuar dhe/ose të çdo anëtar tjetër të Këshillit, brenda 3 (tre) ditëve nga marrja e këtij njoftimi. Po ashtu, kandidati u njoftua edhe për detyrimin për plotësimin e formularit deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij, formular ky që i është bashkëngjitur njoftimit.

4. Brenda afatit treditör, kandidati, z. {...}, depozitoi rregullisht të plotësuar formularin deklarues për adresën postare, adresën elektronike dhe kontaktit telefonik, për qëllimet e procedurës së verifikimit ndaj tij. Nga ana tjetër, në këtë afat, kandidati nuk parashtrroi asnjë pretendim në lidhje me relatorin e caktuar për procedurën e verifikimit ndaj tij apo për ndonjë anëtar tjetër të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

5. Më datë 20.07.2020, bazuar në pikën 8, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, kandidati, z. {...}, në rrugë elektronike, iu dërguan formularët dhe autorizimet përkatëse (të përcaktuara në pikën 6, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019) që duhet të plotësoheshin dhe dorëzoheshin prej tij në kuadër të procedurës së verifikimit të kushteve dhe kritereve ligjore të kandidimit.

6. Brenda afatit pesëditor, kandidati, z. {...}, depozitoi formularët dhe autorizimet përkatëse, ndërsa brenda afatit të përcaktuar në Vendimin nr. 257, datë 20.07.2020, që ishte data 04.08.2020 (sipas pikës 4, Seksioni A, Kreu IX, të Vendimit 75/2019), ai dorëzoi rregullisht edhe formularin “Deklaratë e pasurisë dhe interesave privatë e kandidatit për pozicione të ndryshme në institucionet e sistemit të drejtësisë” pranë Inspektoratit të Lartë të Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (më poshtë referuar si ILDKPKI).

7. Në vijim të procedurës së verifikimit, në datën 28.07.2020 bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion dhe raportim nga institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, përcaktuar në nenin 32 të Ligjit të Statusit, për kandidatët për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, ndër ta edhe për z. {...}.

8. Institucionet kompetente për verifikimin e pasurisë dhe të figurës, kanë përcjell për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet dhe raportimet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

9. Gjatë procedurës së verifikimit, më datë 28.07.2019, mbështetur në të dhënat e deklaruara nga vetë kandidati në jetëshkrimin e depozituar në rastin e aplikimit pranë Shkollës së Magjistraturës, në lidhje me eksperiencën e tij në punë (punësimin), bazuar në pikën 10, Seksioni B, Kreu VI, të Vendimit 75/2019, përmes shkresave të veçanta, u kërkua informacion nga subjektet që kanë mbikëqyrur disiplinën në punë të kandidatit z. {...}, të cilët kanë përcjellë për Këshillin e Lartë Gjyqësor informacionet e tyre në kohë të ndryshme (siç do të përshkruhet më poshtë).

II. REZULTATET E VERIFIKIMIT PËR KRITERET E PRANIMIT NË FORMIMIN FILLESTAR TË SHKOLLËS SË MAGJISTRATURËS

A. Për kriteret e përgjithshme dhe të veçanta të zgjedhshmërisë për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat

10. Sa i përket kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përfshirë edhe për kandidatin {...}, si dhe më lart u parashtrua, vlerësimi për plotësimin e tyre është bërë, në momentin e kandidimit, nga ana e Shkollës së Magjistraturës, bazuar kjo në nenin 30 (“Kandidimi dhe vlerësimi paraprak i kandidatëve”) të Ligjit të Statusit. Në përfundim të vlerësimit, Shkolla ka përgatitur dhe i ka paraqitur Këshillit të Lartë Gjyqësor raportin për rezultatet e vlerësimit paraprak së bashku me dosjet me dokumentet e kandidimit për secilin kandidat, ku pas komenteve të Këshillit, më datë 19.06.2020, Shkolla ka miratuar dhe publikuar në faqen e saj zyrtare Raportin e Vlerësimit Përfundimtar, përfshirë dhe listën e kandidatëve, të cilët plotësonin kriteret e parashikuara në nenin 28 të Ligjit të Statusit. Në këtë listë është përfshirë dhe kandidati {...}.

11. Gjithsesi, për kandidatin {...}, u konsiderua verifikimi sërish i disa prej kriterëve të përgjithshme dhe të veçanta për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, përcaktuar në nenin 28 të Ligjit të Statusit.

11.1 Për këtë u mbajt në konsideratë diferenca kohore mes momentit të aplikimit të kandidatëve (Shkurt 2020), momentit të vlerësimit përfundimtar nga Shkolla e Magjistraturës për plotësimin e kritereve nga ana e tyre (19 Qershor 2020), si dhe momentit aktual, kur Këshilli duhet të shprehet për kualifikimin ose jo të kandidatëve për në formimin fillestar të Shkollës së Magjistraturës, të cilët kanë rezultuar fitues në provimin e pranimit (Shtator 2020). Dhe po ashtu, nga ana tjetër, u mbajt në konsideratë dhe fakti se shumica e kritereve të pranimit në formimin fillestar janë potencialisht të ndryshueshëm në kohë (me përjashtim të kriterit arsimor, kriterit të përvojës profesionale, kriterit të anëtarësisë në parti politike, në kohën e kandidimit dhe kriterit të anëtarësisë, bashkëpunëtorit ose të favorizuarit nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990).

11.2 Gjithashtu, për këtë u mbajt në konsideratë se një verifikim i tillë është detyrim ligjor për Këshillin e Lartë Gjyqësor që buron nga neni 32 (“Verifikimi i pasurisë dhe figurës”), pika 4, shkronja “c”, të Ligjit të Statusit, sipas të cilit Këshilli ka detyrimin të verifikojë ekzistencën e çdo shkakut përjashtues (të parashikuar nga ligji) nga kandidimi për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës. Përveç kësaj, u mbajt në konsideratë detyrimi i Këshillit për verifikimin e kritereve të zgjedhshmërisë, të cilat janë njëherazi edhe kriteret e pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, pra ato sipas nenit 28 të Ligjit të Statusit, është një detyrim konstant i Këshillit qoftë në momentin e emërimit të diplomuarve për magjistrat (profili gjyqtar) në Shkollën e Magjistraturës, ashtu edhe gjatë karrierës së tyre si magjistrat (gjyqtar), referuar për këtë në nenet 35, 64 dhe 66 të Ligjit të Statusit.

12. Konkretisht, për kandidatin u verifikua:

a) pasja nga ai e zotësisë së plotë për të vepruar, ku për këtë nuk u gjet ndonjë e dhënë për heqjen apo kufizimin e tij me vendim gjyqësor të formës së prerë;

b) pasja e shtetësisë shqiptare, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti letër njoftim, lëshuar nga Ministria e Brendshme më datë 30.01.2020, ku pasqyrohet përbërësi i gjendjes civile “shtetësia”, që në këtë rast pasqyrohet “shqiptare”. Gjithashtu, nga verifikimi i bërë, më datë 04.09.2020, në regjistrin kombëtar elektronik të gjendjes civile të administruar nga Ministria e Brendshme (Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile), sipas certifikatës personale elektronike të printuar në letër nga nëpunësi i ngarkuar i Këshillit, konstatohet se kandidati vijon të ketë shtetësinë shqiptare;

c) gjendja gjyqësore, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kjo e fundit ka kryer verifikim në regjistrin elektronik gjyqësor të administruar nga Ministria e Drejtësisë (Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve), duke printuar në letër Vërtetim i Gjendjes Gjyqësore nr. 11 datë 17.02.2020, ndërsa gjatë verifikimit, në kuadër edhe të verifikimit të figurës së kandidatit, u administruan Shkresa

nr.7733/1 prot., datë 30.07.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjqësore). Sipas këtyre dokumenteve, kandidati nuk është e dënuar me vendim penal të formës së prerë;

ç) disiplina në punë, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës janë depozituar Vërtetim nr. 258 prot., datë 11.02.2020 dhe letër rekomandimi e datës 06.02.2020 nga Universiteti Politeknik i Tiranës , ndërsa gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr.814/1 prot., datë 10.08.2020 e Universitetit Politeknik të Tiranës. Gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr.879/1 prot., datë 11.08.2020 e Drejtorisë Rajonale Berat OSHEE sh.a. Gjithashtu verifikimet Këshilli iu drejtua me shkresë nr. 3665/2 prot., datë 28.07.2020 pranë shoqërisë “Kuarta shpk” subjekt i cili gjatë verifikimeve në Qendrën Kombëtare të Biznesit figuron me status “Pezulluar”. Si dhe me shkresë nr. 3665 prot., datë 28.07.2020 pranë shoqërisë “Armo sha” subjekt i cili mbas disa tentativave ne rruge postare nuk morëm asnjë përgjigje me shënimin (larguar nga selia e deklaruar në QKB). Sipas dokumenteve te kandidati nuk është e larguar nga puna për shkaqe disiplinore apo ai nuk ka masë disiplinore në fuqi;

d) qenia bashkëpunëtore, informatorë, ose agjente i shërbimeve sekrete, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 24.02.2020 në të cilën deklaron se nuk ka qenë bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit bashkëpunëtor, informator, ose agjent i shërbimeve sekrete.

12.1. Për kriteret e tjera të pranimit në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës u konsiderua vlerësimi i bërë nga kjo e fundit dhe konkretisht për:

a) pasja e kriterit arsimor për pranimin në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, është depozituar dokumenti “Diplomë në Drejtësi”, me nr.10506, datë 05.07.2007, lëshuar nga Universiteti i Tiranës, Listë Notash më datë 05.07.2007, lëshuar nga Universiteti i Tiranës.

b) pasja e përvojës profesionale, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës është depozituar dokumenti “Librezë Punë”, ndërsa gjatë verifikimit u administruan Shkresa nr. 1542/9 prot., datë 07.08.2020, e Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve dhe Shkresa nr. 4410/1 prot., datë 05.08.2020, e Institutit të Sigurimeve Shoqërore. Sipas këtyre dokumenteve, kandidati ka përvojë profesionale aktive me kohë të plotë në administratën publike dhe privat, konkretisht si “Administrator” pranë Universitetit Politeknik Tiranë .

c) anëtarësia në parti politike, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 24.02.2020 në të cilën deklaron se nuk është anëtare

e ndonjë partie politike, ndërkohë që nuk u gjet ndonjë e dhënë për qenien e kandidatit anëtar i ndonjë partie politike;

ç) qenia anëtare, bashkëpunëtoare ose e favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, ku për këtë, në rastin e aplikimit përpara Shkollës së Magjistraturës, kandidati ka depozituar një deklaratë me shkrim datë 24.02.2020 në të cilën deklaroi se nuk ka qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara vitit 1990, ndërkohë që për vetë moshën e tij (i datëlindjes 07.09.1983) ai nuk mund të ketë qenë i tillë;

B. Për kriterin e pasurisë

13. Për kandidatin {...} u verifikua kriteri i pasurisë, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

14. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...}, u kërkua raportim nga ILDKPKI-ja, e cila ka dërguar në Këshillin e Lartë Gjyqësor Raportin nr. 265/25 prot., datë 25.09.2020.

14.1 Sipas këtij Raporti ILDKPKI-së, kandidati {...} ka plotësuar dhe depozituar në afatin e caktuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor formularin e deklaratës së pasurisë, si dhe autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë.

14.2 Po ashtu, sipas këtij Raporti të ILDKPKI-së, nga kjo e fundit janë kryer kontrollin e plotë për pasuritë, asetet dhe interesat e deklaruara nga kandidati {...}, duke konkluduar se për kandidatin :

- a) deklarimi është i saktë në përputhje me ligjin;
- b) ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasurinë;
- c) nuk ka kryer fshehje të pasurisë;
- d) nuk ka kryer deklaram të rremë;
- e) subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave.

15. Për verifikimin e kriterit të pasurisë për kandidatin {...} u kërkua informacion Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave.

15.1 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve informacioni i dërgua me Shkresën nr. 15042/9 prot., datë 07.08.2020 dhe Shkresa nr. 9254/1 prot., datë 17.09.2020, e Drejtorisë Rajonale e Tatimeve Tiranë, ku për kandidatin {...} rezultoi si person fizik me nipt L61308072S me aktivitet “Avokat”, situata e detyrimeve tatimore nga ana e kandidatit është zero. Gjithashtu kandidati {...} rezultoi si aksione individ

i kompanisë SOOCIIS me nipt L81909008T me aktivitet “Shërbime Avokatie” subjekt ka detyrime të papaguara por janë brenda afatit ligjor të shlyerjes. Nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës me Shkresë nr. 8278/1 prot., datë 18.08.2020 është përcjellë informacioni se Subjekti Four Season Hotel & Resort me nipt L63028804N me administrator kandidati {...} për periudhën (datë 27.08.2019 deri me 27.07.2020), periudhë në të cilën detyrimet ndaj kandidatit janë zero. Gjithashtu nga Drejtoria Rajonale e Tatimeve Durrës është përcjell informacioni se Subjekti E.B.C OIL Company me nipt L11401023A me administrator kandidati {...} për periudhën (datë 26.06.2015 deri me 10.04.2017).

15.2 Nga Drejtoria e Përgjithshme e Doganave informacioni u dërgua me Shkresën nr. 14353/1 prot., datë 10.08.2020, ku për kandidatit {...} nuk jepet ndonjë e dhënë me karakter pasuror.

16. Të dhënat e dërguara përmes informacioneve respektive nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve dhe Drejtoria e Përgjithshme e Doganave u ballafaquan me të dhënat sipas Raportit të ILDKPKI-së, duke u vlerësuar se nuk kishte vend për t’u kërkuar ILDKPKI-së bërja e një kontrolli shtesë.

17. Nga verifikimi i kriterit të pasurisë për kandidatit {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të tij. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e deklaratës së pasurisë;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimet e kërkuara për verifikimin e pasurisë;
- c) kandidati ka burime financiare për të justifikuar pasuritë e tij;
- ç) deklarimi nga kandidati i pasurisë, asetëve ose të interesave private, të detyrueshme për t’u deklaruar, është i plotë, i vërtetë dhe i saktë.

C. Për kriterin e figurës sipas nenit 32 të Ligjit të Statusit

18. Për kandidatit {...} u verifikua kriteri i figurës, përcaktuar në pikën 1, të nenit 32, të Ligjit të Statusit.

19. Konkretisht, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatit {...}, u kërkuar raportim nga institucionet ligjzbatuese të përcaktuara në pikën 2, të nenit 32, të Ligjit për Statusit, me përjashtim të Byrosë Kombëtare të Hetimit, e cila nuk ka filluar ende ushtrimin e funksioneve të saj pasi vetëm së fundmi

Këshilli i Lartë i Prokurorisë ka emëruar Drejtorin e Byrosë Kombëtare të Hetimit¹, ndërsa më datë 08.09.2020, janë hapur aplikimet për hetues të këtij institucioni².

20. Nga raportimet e shërbimeve shtetërore informative nuk u identifikua dhe verifikua ndonjë e dhënë për lidhje ose kontakte të papërshtatshme të kandidatit {...} me persona të përfshirë në krimin e organizuar apo për përfshirjen e tij në veprimtari që cenojnë sigurinë kombëtare apo aktivitetet të kundërligjshme.

21. Po ashtu, për verifikimin e kriterit të figurës për kandidatin {...}, atij iu kërkua dhe ai plotësoi dhe depozitoi rregullisht pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, më datë 23.07.2020, formularin e vetë deklaramit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, si dhe autorizimin për Këshillin që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, të të dhënave të tij në lidhje me figurën dhe integritetin.

22. Në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesën e Këshillit të Lartë Gjyqësor, Prokuroria e Përgjithshme ka kryer verifikimin përkatës në të gjitha prokuroritë që ushtrojnë veprimtari në Republikën e Shqipërisë, duke përcjellë në Këshill, me Shkresën nr. 1166/36 prot., datë 28.09.2020, përgjigjet zyrtare të 29 (njëzetënëntë) prokurorive pranë gjykatave të shkallës së parë, apelit si dhe përgjigjen e Prokurorisë së Posaçme kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar. Referuar përmbajtjes së këtyre përgjigjeve rezulton se për kandidatin {...}, nuk është regjistruar kallëzim/referim/procedim penal, nuk ka qenë ose është në hetim, nuk është caktuar ndonjë masë sigurimi, nuk është dënuar me vendim jo përfundimtar apo të formës së prerë për kryerjen e ndonjë vepre penale.

22.1 Bazuar në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike” Këshilli iu drejtuar me shkresë nr. 4839 prot., datë 02.10.2020 dhe shkresë nr. 3665/6 prot., datë 02.10.2020 me lëndë kërkesë për dokumentacion dhe informacion.

23. Po në kuadër të zbatimit të Ligjit nr. 138/2015 “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, mbi kërkesë të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, me Shkresën nr. 5543/1 prot., datë 01.10.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr.3631/1, datë 02.10.2020, ka dërguar të dhënat për përbërësit e gjendjes civile edhe

¹ Vendimi nr.183, datë 30.07.2020.

² Sipas njoftimit në faqen zyrtare: <https://bkh.al/2020/09/08/njoftim-per-shpalljen-e-konkursit-per-pozicionet-hetues-ne-byrone-kombetare-te-hetimit/>

për kandidatin {...}, pas verifikimeve të bëra në Regjistrin Kombëtar të Gjendjes Civile të vitit 2010 dhe në zyrat përkatëse të gjendjes civile.

24. Bazuar në informacionin e dërguar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve (Sektori i Gjendjes Gjyqësore) dhe Drejtoria e Përgjithshme e Shërbimit të Gjendjes Civile, nëpunësi përgjegjës i strukturës së posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi kreu verifikimet e rastit, nuk konstatoi mangësi në të dhënat e deklaruara nga kandidati {...} në formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015, “Për garantimin e integritetit të personave që zgjidhen, emërohen ose ushtrojnë funksione publike”, duke konkluduar se kandidati: *“ - ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 23.7.2020; - formulari i vetëdeklarimit është bërë publik, në faqen zyrtare të web; - në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji Por ka deklaruar i ndaluar e arrestuar , nga prokuroria e rrethit Gjyqësor Fier, kundërshtim të punonjësve që kryejnë një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, neni 235/2 i kodit penal, datë 11.07.2013. Arrestim në flagrancë, vlerësuar si i ligjshëm me vendim nr. 416 datë 1507.2013, nga Gjykata e Shkallës së Parë Fier. Me vendimin nr.240 datë 30.08.2013, Gjykata e Apelit Vlorë ka vlerësuar të paligjshëm arrestimin në flagrancë. Ka deklaruar dhe masën detyrim për tu paraqitur me vendim nr. 146 datë 15.07.2013 nga Gjykata e Shkallës së Parë Fier, lënë në fuqi me vendim nr.240 datë 30.08.2013 nga Gjykata e Apelit Vlorë neni 235/2, kundërshtim të punonjësve që kryejnë një detyrë shtetërore ose një shërbim publik, nga data 15.07.2013 deri në datë 25.11.2013. Me vendimin datës 25.11.2013 i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, për pushimin e procedimit penal nr. 254, datë 12.07.2013, për shkak se fakti nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Ky informacion është dërguar për verifikim pranë Prokurorisë së Përgjithshme, ; - nga përgjigjet e ardhura nga zyra e gjendjes gjyqësore dhe zyra e gjendjes civile, nuk ka rezultuar ndryshime të dhënave të gjendjes civile apo gjendjes gjyqësore, nga ato të deklaruara; - deri më sot nuk kemi pasur indicie apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”.*

24.1 Sa sipër, nga informacioni i ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme me shkresën nr. 1166/244 prot. datë 23.11.2020, protokolluar në Këshill me aktin nr. 4839/6, datë 24.11.2020, pas verifikimeve të kryera, me vendimin e datës 23.11.2020 është vendosur :

“1. Miratimin e rezultateve të verifikimit në lidhje me subjektin deklarues {...} Nevrus {...}, kandidat për magjistrat, profili gjyqtar, si më poshtë :

- a. Nuk rezultoi të ketë kryer ndryshime në përbërësit e gjendjes civile të padeklaruara në formular të ndryshme nga ato të deklaruara;*
- b. Nuk rezultoi i dënuar me vendim të formës së prerë, për kryerjen e ndonjë vepre penale, nga autoritet gjyqësor shqiptar;*

- c. Nuk rezultoi i dënuar me vendim gjyqësor jo përfundimtar nga autoritet gjyqësor shqiptar për një çështje penale të pazgjidhur me vendim gjyqësor të formës së prerë;
- d. Rezultoi të ketë qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese shqiptare, për kryerjen e një vepre penale ashtu si është deklaruar në formular;
- d.1 Me vendimin nr. 416 datë 13.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për shtetasin {...}, është vleftësuar i ligjshëm “arrestimi në flagrancë” dhe caktuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” si i dyshuar për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik” të parashikuar nga neni 235/2 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 240 datë 30.08.2013, ka miratuar vendimin nr. 416 datë 15.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, sa i përket caktimit të masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” ndaj të hetuarit {...}, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 235/2 i Kodit Penal dhe ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm, lidhur me vleftësimin e arrestimit në flagrancë ndaj shtetasit {...}, duke e vleftësuar si të paligjshëm atë.
- e. Rezultoi të ketë qenë i siguruar me masë shtrënguese të sigurisë personale nga një autoritet shqiptar;
- e.1 Ashtu si është deklaruar në formularin e vetëdeklarimit me vendimin nr. 416 datë 13.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier për shtetasin {...} është vleftësuar i ligjshëm “arrestimi në flagrancë” dhe caktuar masa e sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” si i dyshuar për veprën penale të “Kundërshtimit të punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik” të parashikuar nga neni 235/2 i Kodit Penal. Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. 240 datë 30.08.2013, ka miratuar vendimin nr. 416 datë 15.07.2013 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, sa i përket caktimit të masës së sigurimit “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” ndaj të hetuarit {...}, i dyshuar për kryerjen e veprës penale të parashikuar nga neni 235/2 i Kodit Penal dhe ka vendosur ndryshimin e vendimit të mësipërm, lidhur me vleftësimin e arrestimit në flagrancë ndaj shtetasit {...}, duke e vleftësuar si të paligjshëm atë.....”.

24.2 Rezultatet e verifikimit të thelluar ardhur nga Prokuroria e Përgjithshme, u shqyrtua nga Struktura e Posaçme pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor, e cila bazuar në të dhënat e grumbulluara edhe gjatë verifikimit të thelluar, përmes shkresës nr. 4839/9 prot. datë 27.11.2020, informon se kandidati {...} :

“- ka dorëzuar formularin e vetëdeklarimit më datë 23.07.2020;

- nga struktura e posaçme formulari është numërtuar me numrin rendor 000518;

- formulari i vetëdeklarimit është bërë publik në faqen zyrtare të web;

- në formularin e vetëdeklarimit, nuk ka të deklaruar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji, por subjekti ka deklaruar me Vendimin nr. 416, datë 13.07.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier është vleftësuar i ligjshëm arrestimi në flagrancë” dhe caktuar masa e sigurisë “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” për veprën penale “Kundërshtim i punonjësit që kryen një detyrë shtetërore ose një shërbim publik” dhe me Vendimin nr. 240, datë 30.08.2013, Gjykata e Apelit Vlorë, ka miratuar Vendimin nr. 416 datë 13.07.2013 të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, sa i përket caktimit të masës së sigurisë “Detyrim për t’u paraqitur në policinë gjyqësore” ndaj të hetuarit dhe ka vendosur ndryshimin e vendimit, lidhur me vleftësimin e “arrestimit në flagrancë” ndaj tij, duke e vleftësuar të paligjshëm. Në lidhje me këtë deklaram, struktura e posaçme ju drejtua për verifikim pranë Prokurorisë së Përgjithshme e cila në përfundim të verifikimit ka konstatuar se ka qenë i ndaluar apo arrestuar nga organet ligjzbatuese, për kryerjen e një vepre penale ashtu si është deklaruar nga subjekti, duke kërkuar nga KLGJ si organ përgjegjës të vlerësojë nëse deklaramet janë brenda sferës së kufizimeve apo ndalimeve, sipas ligjit nr. 138/2015;

- nga përgjigjet e ardhura nga Drejtoria e Shërbimit të Gjendjes Civile, nuk ka rezultuar ndryshime në të dhënat e gjendjes civile në raport me ato të deklaruara në formularin e vetëdeklarimit;

- për shkak të dhënave të konstatuara që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji, për kandidatin është kërkuar verifikim i thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme;

- nga verifikimi i thelluar prej Prokurorisë së Përgjithshme, për kandidatin nuk kanë rezultuar të dhëna që përfshihen brenda sferës së ndalimeve të parashikuara nga ligji;

- aktualisht nuk ka indicie të tjera apo të dhëna kryesisht, për të kërkuar verifikim të thelluar nga Prokuroria e Përgjithshme”.

25. Nga verifikimi i kriterit të figurës për kandidatin {...} janë grumbulluar të dhëna të mjaftueshme mbi të cilat mund të konkludohet për ekzistencën e shkaqeve të kualifikimit ose skualifikimit të tij. Konkretisht, të dhëna në lidhje me:

- a) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht formularin e vetëdeklarimit sipas kërkesave të Ligjit nr.138/2015;
- b) kandidati ka plotësuar dhe depozituar rregullisht, të nënshkruara, autorizimin për Këshillin e Lartë Gjyqësor që, në zbatim të pikës 2 të nenit 32 të Ligjit për Statusin, të kryejë verifikimin në organet kompetente sipas ligjit, për të dhënat që lidhen me figurën dhe integritetin e tij;

- c) për kandidatin nuk ka të dhëna për lidhje ose kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar;
- ç) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë anëtar, bashkëpunëtor ose i favorizuar nga Sigurimi i Shtetit përpara datës 2 korrik 1991, në kuptimin e Ligjit nr.45/2015 “Për të drejtën e informimit për dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit të Republikës Popullore Socialiste të Shqipërisë”;
- d) për kandidatin nuk ka të dhëna që të ketë qenë ose të jetë bashkëpunëtor, informatorë ose agjent i shërbimeve të inteligjencës;
- dh) për kandidatin nuk ka ndonjë të dhënë tjetër në lidhje me figurën dhe integritetin e tij mbi të cilën të ngrihen dyshime për pranueshmërinë e tij për në formimin fillestar për magistrat në Shkollën e Magistraturës.

III. KONKLUZIONE

26. Referuar përcaktimeve të Vendimit 75/2019, nga shqyrtimi i dokumentacionit të administruar gjatë procedurës së verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson procedura e verifikimit e ndjekur në këtë rast është e plotë dhe në përputhje me ligjin.

27. Bazuar në sa më lart është parashtruar mbi rezultatet e verifikimit të kriterëve ligjore të kandidimit për kandidatin z. {...}, Këshilli i Lartë Gjyqësor vlerëson se kandidati përmbush këto kriterë, ndërsa nuk ekziston ndonjë shkak për skualifikimin e tij. Nisur nga kjo, Këshilli çmon se është vendi për kualifikimin e kandidatit për në formimin fillestar për magistrat, profili gjyqtar, në Shkollën e Magistraturës, për vitin akademik 2020-2021.

PËR KETO ARSYE

Mbështetur në nenin 32, pika 5, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 61, pika 1, në nenin 86, shkronja “ë” dhe në nenin 97, pika 1, shkronja “a”, të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe Kreun VI, Seksioni Ç, pika 12, shkronja “a”, të Vendimit të Këshillit të Lartë Gjyqësor nr. 75, datë 23.05.2019 “Për procedurën e verifikimit të kushteve dhe kriterëve ligjore për rekrutimin e kandidatëve për gjyqtarë, për zhvillimin e karrierës së gjyqtarëve dhe për emërimin e gjyqtarëve të Gjykatës së Lartë”, Këshilli i Lartë Gjyqësor,

V E N D O S I

1. Kualifikimin e kandidatit z. {...}, për në formimin fillestar në Shkollën e Magjistraturës, për magjistrat, profili gjyqtar, në vitin akademik 2020-2021.
2. Një kopje e arsyetuar e vendimit i njoftohet kandidatit z. {...} sipas kërkesave të nenit 98 të Ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe bëhet publik në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor, pasi të redaktohet për sigurimin e anonimatit të subjekteve.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të internetit të Këshillit të Lartë Gjyqësor.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR